



Datë: 01.09.2025
Numër Protokolli: 5831/2025

A.nr.1296/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1296/2025, të datës 04.07.2025, të parashtruar nga ankuesi B.K, nga Prishtina, kundër organit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1296/2025, e datës 04.07.2024, e parashtruar nga ankuesi B.K.

II.Shfuqizohet Njoftimi i datës 04.02.2025 i Njesisë së Burimeve Njerëzore, ndërsa **Anulohet** në tersi procedura e rekrutimit e shpallur sipas konkursit të datës 25.05.2025 me numër të Referencës RN00017884 për pozitën Zyrtar i Lartë për Arkitekturë-Projekt, të shpallur nga Komuna e Prishtinës.

III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës, që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën **II** të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, B.K (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 04.07.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër procedurës së rekrutimit me shifër RN00017884 për pozitën Zyrtar i Lartë për Arkitekturë-Projekt, të shpallur nga Komuna e Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 14.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit, me datë 21.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 14.08.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:5502/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1296/2025 të datës 04.07.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 4507/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 04.07.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin përfundimtar të datës 30.06.2025; Vendimin e datës 10.06.2025 të Njesisë së Burimeve Njerëzore; Njoftimin për verifikimin paraprak i datës 10.06.2025; Konkursin e datës 22.05.2025; Kopjen e pasaportës së ankuesit; Pasqyra e llogarisë trust; Kontratë e datë 28.03.2025; Kontratë e datë 08.04.2022; Kontratë e datë 09.07.2021; Kontratë e datë 29.08.2023; Kërkesë për përgjigje ankesë e datës 14.07.2025; Përgjigje në ankesë e datës e 21.07.2025; Vendimin e datës 09.06.2025; Akt Emërimit e datës 08.02.2023; Akt Emërimit e datës 01.10.2022; Akt Emërimit 01.02.2017; Aplikacionin e datës 29.05.2025 të kandidatës A.B me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 28.05.2025 të kandidatës A.D me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 30.05.2025 të kandidatës B.B me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 29.05.2025 të kandidatës E.I-S me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 30.05.2025 të kandidatës I.N me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 28.05.2025 të kandidatës A.D me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 30.05.2025 të kandidatës S.B me dokumentacionin e bashkangjitur; Aplikacionin e datës 27.05.2025 të ankuesit me dokumentacionin e bashkangjitur: Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 14.08.2025.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e **bazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Komuna e Prishtinës, më datë 22.05.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00017884, për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit, pozita “Zyrtar i Lartë për Arkitekturë-Projekt”, numri i kërkuar 3, në Drejtorinë e Urbanizimit, ku afati për aplikim ka qenë nga data 22.05.2025 deri më 01.06.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, konstatohet fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Tutje, Njësia e Burimeve Njerëzore, përmes Vendimit të datës 10.06.2025 ia ka refuzuar aplikacionin ankuesit me arsyetimin se i mungojnë kopjet e dëshmisë (kontratë/vërtetimi) i punësimit të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe angazhimin në atë pozitë, ndërsa sipas Njoftimit Nr.14-111/01-0094265/25 të datës 30.06.2025 rezulton se kandidatët fitues, janë: A.D me gjithsejtë 74 pikë, E.I-S me gjithsejtë 72.67 pikë dhe B.B me gjithsejtë 70.67 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se procedurat e rekrutimit janë zhvilluar në kundërshtim me Rregulloren 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e përgjithshme Administrative, me arsyetimin se i kanë plotësuar kriteret e konkursit dhe kam bashkangjitur dokumentacionin e nevojshëm, me kërkesën që Këshilli të aprovoi si të bazuar ankesën e ankuesit ndërsa të anuloi Njoftimin e datës 30.06.2025.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe duke u bazuar në bazën ligjore në fuqi, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit me Nr. reference RN00017884, për **Grupi i Inxhinierisë së Ndërtimit**, pozita “Zyrtar i Lartë për Arkitekturë” ka konstatuar se për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për fushën TIK. Kërkesat specifike:* *Inxhinieri e Ndërtimit, Inxhinier Strukturore, Inxhinieri Arkitekture, Inxhinieri Gjeoteknike, Hidroteknikë. Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase; Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”,* ndërsa sipas konkursit në fjalë arsye e rekrutimit ka qenë realizimi i një projekti ashtu që kohëzgjatja e emërimit do të jetë tre (3) vite, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 37, paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Fillimisht Kolegji i Këshillit, në frymën e dispozitave të nenit 37 paragrafi 3 dhe 6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, analizoi dhe mori për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 2 paragrafi 1 të Rregullores NR.03/2024 Për Themelimin e Marrëdhënies së Punës Kontratë për Periudhë të Caktuar ku përcaktohet se: “1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të gjitha institucionet e administratës shtetërore si dhe në institucionet e tjera shtetërore me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës me kohë të caktuar.” ndërlidhur me nenin 10 paragrafi 1 dhe nenit 13 paragrafit 2 ku përcaktohet se: “**10.1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit, nëse kandidatët për përzgjedhje në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 13.2. Komisioni i Përzgjedhjes ka tre (3) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. dy (2) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) nëpunës profesional i specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi.**”, dhe mbi këtë baza analizoi shkresat e lëndës me qëllim të konstatimit nëse komisioni i pranimit është themeluar në pajtueshmëri me dispozitat e rregullores në fjalë, si dhe nëse kandidatët e suksesshëm të përcaktuar sipas njoftimit të datës 30.06.2025 i plotësojnë apo jo kriteret e përcaktuara si në konkursin e datës 22.05.2025 me numër reference RN00017884.

Kolegji i Këshillit konstatoi se Kryetari i Komunës së Prishtinës, përmes Vendimit të datës 09.06.2025 me numër:14-020/04-00800030/25 ka themeluar Komisionin e Pranimiit në përbërje prej tre (3) anëtarësh, si në vijim: F.D-Kryesues i cili sipas Akt të Emërimit të datës 01.10.2022 mban pozitën e punës “*Udhëheqës i Sektorit të Legalizimit*”, N.F-anëtare, e cila sipas Aktit të Emërimit të datës 08.02.2023 mban pozitën e punës “*Udhëheqëse e Sektorit të Urbanizimit*”, dhe J.M-K anëtare, e cila sipas Aktit të Emërimit të datës 01.02.2017 mban pozitën e punës “*Udhëheqëse e Sektorit të Mjedisit dhe Eficiencës*”, andaj Kolegji i Këshillit konstatoi se komisioni në fjalë është i themeluar në kundërshtim me dispozitat e 13 paragrafit 2 Rregullores NR.03/2024 Për Themelimin e Marrëdhënies së Punës Kontratë për Periudhë të Caktuar, pasi që norma në fjalë themelimin e komisionit e parashikon në atë mënyrë, ashtu që prej tre (3) anëtarëve sa duhet të ketë komisionin përkatëse, dy (2) prej tyre duhet të jenë nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, kurse një nëpunës profesional i specializuar në fushën përkatëse, ndërsa në rrethanat e rastit konkret Komisioni i pranimiit sipas Vendimit të datës 09.06.2025 është themeluar në përbërje prej tre (3) anëtarë, ndërsa që të tre janë të nivelit të ulët drejtues, pra në përbërje të komisionit s’ka nëpunës civil të kategorisë profesionale sikurse përcaktohet me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit analizoi dosjet e kandidatëve të suksesshëm sipas Njoftimit Nr:14-111/01-0094265/25 të datës 30.06.2025, dhe konstatoi se nga tre (3) kandidatë të suksesshëm, prej tyre dy (2) nuk i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit të datës 25.05.2025 me reference RN00017884, për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit, pozita “*Zyrtar i Lartë për Arkitekturë-Projekt*”, për arsyet e dhëna si në **vijim**:

Kandidatja e suksesshme, B.B posedon Diplomën e datës 21.09.2016 përmes së cilës dëshmohet se e njëjta me datë 05.08.2016 ka diplomuar në Kolegjin UBT në Programin Arkitekturë, nga rrjedh se të njëjtës, përvoja e punës profesionale i llogaritet pas datës 05.08.2016, kurse për përvojën e punës e njëjta ka ofruar si dëshmi Letë rekomandimin e lëshuar nga “Tiki Sh.P.K” përmes së cilësi referohet se e njëjta ka filluar të punoi në këtë kompani nga muaji qershor 2017, mirëpo shkresa në fjalë nuk përmban datën apo kohën e saktë të periudhës së angazhimit në këtë kompani, dhe po ashtu e njëjta ka ofruar Vërtetimin e marrëdhënies së punës të datës 13.08.2024 të lëshuar nga “Lesna Trade Sh.P.K” përmes së cilës shkresë konfirmohet se e njëjta ka filluar punën në këtë kompani nga data 16.10.2023 më kohëzgjatje deri me datë 31.08.2024, ndërsa e njëjta dëshmitë e punësimit nuk i ka mbështetur edhe me dëshmi si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale (Trust) apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (ATK), sikurse ishte përcaktuar në pikën 5 të konkursit të datës 25.05.2025 me reference RN00017884.

Kandidatja e suksesshme, E.I-S posedon Diplomën e datës 17.01.2011 përmes së cilës dëshmohet se e njëjta me datë 17.01.2011 ka diplomuar në Universitetin për Biznes dhe Teknologji UBT-Departamenti për Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, nga rrjedh se të njëjtës përvoja e punës profesionale i llogaritet pas datës 17.01.2011, kurse për përvojën e punës e njëjta ka ofruar si dëshmi Kontratën e Punës të datës 16.08.2010 të lëshuar nga “N.N.T Eurotrans” përmes së cilës konfirmohet se e njëjta ka filluar punën me këtë kompani në kohë të pacaktuar në pozitën e punës Menaxher Projekti, posedon Referencën e lëshuar me datë 28.05.2014 nga Komuna e Gjilanit përmes së cilës konfirmohet

fakti se e njëjta ka kryer praktiken e punës profesionale në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në periudhë kohore prej tetë (8) muajsh nga data 01.06.2013 e deri me datë 31.01.2014, po ashtu e njëjta ka ofruar në cilësi të dëshmisë për përvojë e punës marrëveshjen për shërbime të datës 26.02.2020 me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në kohëzgjatje nga data 16.03.2020 e deri me datë 31.12.2020, e cila gjatë kohës së angazhimit ka kryer shërbimet si në vijim: *“pranimi, klasifikimi dhe fajlimi i dokumentacionit në kopje fizike dhe elektronike lidhur me kërkesat për negociim direkt, pranimi dhe përcjellja e shkresave hyrëse dhe dalëse të njësisë për negociim direkt si dhe fajlimi i tyre, mbajtja e procesverbaleve të njësisë dhe mbikëqyrja e data bazës elektronike të kërkesave për negociim direkt”*, po ashtu posedon marrëveshjen për shërbime të datës 14.08.2019 me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në kohëzgjatje nga data 15.08.2019 e deri me datë 15.03.2020, e cila gjatë kohës së angazhimit ka kryer shërbimet si në vijim: *“pranimi, klasifikimi dhe fajlimi i dokumentacionit në kopje fizike dhe elektronike lidhur me kërkesat për negociim direkt; pranimi dhe përcjellja e shkresave hyrëse dhe dalëse të njësisë për negociim direkt si dhe fajlimi i tyre, mbajtja e procesverbaleve të njësisë dhe mbikëqyrja e data bazës elektronike të kërkesave për negociim direkt”*, po ashtu posedon marrëveshjen për shërbime me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në kohëzgjatje nga data 01.01.2021 e deri me datë 30.06.2021, e cila gjatë kohës së angazhimit ka kryer shërbimet si në vijim: *“pranimi, klasifikimi dhe fajlimi i dokumentacionit në kopje fizike dhe elektronike lidhur me kërkesat për negociim direkt, pranimi dhe përcjellja e shkresave hyrëse dhe dalëse të njësisë për negociim direkt si dhe fajlimi i tyre, mbajtja e procesverbaleve të NjND-së; mbikëqyrja e data bazës elektronike të kërkesave të NjND-së; asistimi i zyrtarëve të NjND-së për përgatitjen e kopjeve fizike të dokumentacionit për mbledhjen e Bordit të drejtorëve të AKP-së; si dhe detyrat e tjera të caktuara nga Autoriteti i Likuidimit”*, ndërsa e njëjta dëshmitë e punësimit sipas Kontratës së Punës të datës 16.08.2010 të lëshuar nga “N.N.T Eurotrans” nuk i ka mbështetur edhe me dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale (Trust) apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale (ATK), sikurse ishte përcaktuar në pikën 5 të konkursit të datës 25.05.2025 me reference RN00017884, ndërsa për përvojën e punës të deklaruar në Agjencinë Kosovare të privatizimit sipas marrëveshjeve për shërbime për periudhën kohore të cekur si më lartë, përvoja e tillë në bazë të detyrave të punës apo shërbimeve të kryera nga kandidatja në fjalë, nuk mund të llogaritet si përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura e përkatëse e rekrutimit, çështje kjo e përcaktuar në kriterin e konkursit të datës 25.05.2025 me referencë RN00017884, si në pikën 3 ku ishte kërkuar: ***“Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës”***, respektivisht të njëjtës e vetmja përvojë punë profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit është përvoja e punës praktike e deklaruar dhe dëshmuar sipas Referencës e lëshuar me datë 28.05.2014 nga Komuna e Gjilanit përmes së cilës konfirmohet fakti se e njëjta ka kryer praktiken e punës profesionale në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në periudhë kohore prej tetë (8) muajsh nga data 01.06.2013 e deri me datë 31.01.2014.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit lidhur me konstatimin e dhënë si më lartë, që ka të bëjë me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara si në konkursin e datës 25.05.2025, konstatoi se dy (2) kandidatët e cekur si më lartë, të cilët në bazë të Njoftimit të datës 30.06.2025 rezultojnë të jenë edhe kandidatët të suksesshëm, nuk e kanë plotësuar kriterin e konkursin që ndërlidhet me përvojën e punës profesionale prej dy vitesh në fushën për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit, konstatim ky në

bazë të provave të lëndës të ofruara të lëndës nga palët në procedurë, respektivisht Komuna e Prishtinës, nga rrjedh se Komisioni i Pranimi me rastin e përfshirjes së dy (2) kandidatëve në fjalë në listën e ngushtë kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 10 paragrafi 1 të Rregullores Nr.03/2024 Për Themelimin e Marrëdhënies së Punës Kontratë për Periudhë të Caktuar ku përcaktohet se: “1. *Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen në të gjitha institucionet e administratës shtetërore si dhe në institucionet e tjera shtetërore me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës me kohë të caktuar.*” ndërlidhur me nenin 10 paragrafi 1 dhe nenit 13 paragrafit 2 ku përcaktohet se: “**10.1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit, nëse kandidatët për përzgjedhje në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit**”, ngase kanë përfshirë në listë kandidatë të cilët nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit të datës 25.05.2025 përcaktuar si në pikën 3, që lidhet me përvojën e punës.

Duke marrë për bazë konstatimet e dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, meqenëse Kolegji i Këshillit konstatoi se në procedurën e rekrutimit janë evidentuar shkeljet në fazën e verifikimit paraprak, ashtu që dy prej kandidatëve të suksesshëm nuk i kanë plotësuar kriteret e konkursit të datës 25.05.2025, si dhe meqenëse u konstatua fakti po ashtu se Komisioni i Pranimi është themeluar në kundërshtim me rregulloren e fushës përkatëse të evidentuar si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, atëherë Kolegji i Këshillit konstatoi se procedura e rekrutimit është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1. *Pranimi në detyrë i nëpunës/it civil, nëpunës/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunës/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese.*”, dhe mbi këtë bazë, e në mbështetje të dispozitave të aplikuara nga neni 52 paragrafi 1, nën paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “1. *Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.5. është në kundërshtim me ligjin material;*” vendosi që të anuloi Njoftimin e datës 30.06.2025 për kandidatët e suksesshëm dhe po ashtu të anuloi në tersi konkursin me referencë RN00017884, për Grupin e Inxhinierisë së Ndërtimit, pozita “Zyrtar i Lartë për Arkitekturë-Projekt”, të shpallur nga komuna e Prishtinës, sikurse u përcaktua në dispozitivin e këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar vetëm për shkak të shkeljeve të ligjit material lidhur me konstatimet e dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ndërsa nuk Kolegji i Këshillit u lëshua në shqyrtimin e pretendimeve të tij ankimore nëse i njëjti i ka plotësuar kriterin e konkursit që lidhet me përvojën e punës, pasi që në konstatim i tillë apo jo, nuk do të ndryshonte natyrën vendimmarrëse të këtij vendimi në këtë çështje administrative të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit, pasi që Kolegji i Këshillit konstatoi shkeljen e ligjit material të theksuara si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1296/2025, datë 01/09/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.K;
- Komunës së Prishtinës (Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.